



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 03.11.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 31.10.2022, të parashtruar nga Operatori Ekonomik " **BERISHA COM** " SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull : "Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në fshatin Skivjan-faza e dytë-Kontratë dy vjeçare " , Nr. i prokurimit- 632-22-5634-5-2-1 dhe Nr. i brendshëm-632-22-045-521, nxjerr:

V E N D I M

- 1. Refuzohet** si e pa bazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik " **BERISHA COM** " SH.P.K., e dt.31.10.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në fshatin Skivjan-faza e dytë-Kontratë dy vjeçare " , Nr. i prokurimit- 632-22-5634-5-2-1, kundër **NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES** , te AK –së, të datës 26.10.2022, të publikuar në platformën elektronike të KRPP.
- 2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES** të publikuar me datë 26.10.2022;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me procedurat e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

A r s y e t i m

Me dt.31.10.2022, Operatori Ekonomik " BERISHA COM " SH.P.K., ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: "Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në fshatin Skivjan-faza e dytë-Kontratë dy vjeçare " , Nr. i prokurimit- 632-22-5634-5-2-1.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 03.11.2022, ka shqyrtuar kërkesën për rishqyrtim si më poshtë:

Pas shqyrtimit të Kërkesës për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik "BERISHA COM " SH.P.K., të dt.31.10.2022, Autoriteti kontraktues, konstaton se :

-Pretendimi juaj se Operatori ekonomik i propozuar për kontratë nuk e ka prezantuar deklaratat për specifikacione teknike, është i pabazuar sepse një gjë e tillë nuk është e obligueshme;

-Edhe pretendimi juaj lidhur me kontratat dhe referencat nuk qëndron sepse Operatori Ekonomik N.SH.T. VIKTORY COM, i ka prezantuar sqarimet në lidhje me kontrata dhe referenca për punë të ngjashme të kryera të cilat kanë qenë të mjaftueshme për Autoritetin kontraktues

-Pretendimi se Operatori ekonomik i propozuar për kontratë ka paraqitur vetëm kontratat e punës së punëtorëve e jo edhe listën e punëtorëve nga ATK, është i pabazuar sepse kjo nuk është është kërkuar në FDT-ë:

"Lista e kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit tuaj profesional të dëshmohet me CV, diplomë dhe kontrata e punës apo në rast të lidhjes së kontratës mbi vepër duhet specifikuar titullin e projektit për të cilin ka lidhë kontratë, për projekt menaxherin duhet të ofrohet dëshmi dhe vendimi për projekt menaxherin. si dhe lista e numrit të punëtorëve të angazhuar me të dhënat në vijim emri, mbiemri i e punëtorit, profesioni, dhe pozicioni në kompani"

-Pretendimi juaj për ing.të Komunikacionit Uran Mulaj është i pa bazuar sepse Operatori ekonomik i propozuar për kontratë në sqarimet shtesë e ka prezantuar kontratën e inxhinjerit në fjale me emër të projektit dhe të nënshkruar nga të dy palë dhe kjo është e mjaftueshme për Autoritetin kontraktues:



KONTRATË
MBI VEPËR

Ë lidhur me datën 23.06.2022 në Gjakovë në mes të
Uran Mulaj-inxhinier i Komunikacionit (në tekstin e mëtejshëm i punësuar) dhe N.S.H.T Viktory Com
(Pjeter Qerimi B.I) me nr biznesit 810244541 (në tekstin e mëtejshëm punëmarrësi).

Kryerja e punimeve lidhur me objektin investiv:

Titulli: Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në fshatin Skivjan-faza e dytë-Kontratë dy vjeçare

Me nr te prokurimit: Nr. Prokurimit 632-22-5634-5-2-1

NENI 1

Punëdhënësi i ofron të punësuarit kryerjen e punimeve për punë inxhinierike të Komunikacionit .

NENI 2

I punësuarit pranon kryerjen e punëve si në pikën një të kësaj kontrate.

NENI 3

Palët kontraktuese do të kenë kontakte të vazhdueshme gjat gjithë kohës se punimeve,ndërsa pranimi përfundimtar i punimeve do të behet me një procesverbal respektivisht raport zyrtar të nënshkruar nga të dy palëve.

NENI 4

Në rast kontesti kompetent do të jet Gjykata Themelore në Prishtinë.
Kjo kontratë është e hartuar në katër kopje,ku nga një kopje do tu jepet palëve kontraktuese.
Palet Kontraktuese.

I punësuarit:



-Operatori Ekonomik N.SH.T. VIKTORY COM ka prezentuar kontratën, CV, licencën për gjeodetin e licencuar dhe pretendimi juaj se ing.Zef Kanza nuk figuron askund nuk qëndron, sepse i njëjti gjindet në oferten e operatorit në fjalë tek lista e stafit profesional:

N.SH.T VIKTORY COM
(PJETER QERIMI B.I)
NRB: 810244541
NRF: 600767381
Contact: 044 127 092
Email: info@viktory-ks.com
Rr.Tirana,Gjakove
Psot code: 50000

Lista e Stafit Profesional

1. Suad Çmega Gjeo Projekt SH.p.k ing i Gjeodezis I Licensuar
2. Agron Dobra Ing I Gjeodezis I Licensuar
3. Beqe Hadergjonaj Ing I Ndertimitaris
4. Uran Mulaj Ing Komunikacionit
5. Egzon Tofaj Ing Komunikacionit
6. Zef Kaza Ing I Gjeodezis
7. Florent RetkocerI Gjeodet I Licensuar

N.SH.T VIKTORY COM



Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**

Faton Gutaj


Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës